



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 15.07.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për kontrollin e lëndëve narkotike dhe zbatimin e ligjit”.
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2009, për Projektin “Energji Ujore dhe Siguria e Digave në Kaskadën e Drinit”.
4. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2010 për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Dashamir Peza, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vasilika Hysi, Anila Agalliu, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungojnë:

Silva Caka, Fatmir Mediu, Tom Doshi.

Të ftuar:

Saimir Tahiri – ministër i Punëve të Brendshme

Idajet Faskaj - drejtor i AntiNarkotikëve në DPP

Mirela Selita- drejtore e Drejtorise Juridike në MPB

Argita Alikaj- përgjegjëse në Sektorin e Hartimit të Akteve në Ministrinë e Drejtësisë

Ilir Bejtja -zëvendësministër i Energjisë dhe Industrisë

Agim Bregasi – drejtor i Politikave të Zhvillimit Elektroenergjitik në MEI

Enea Karakaci – përgjegjës i sektorit juridik në MEI

Miranda Lila – këshilltare e ministrit

Anisa Pina - specialiste e medias në MEI.

Brikena Jazxhi – përfaqësuese e Ministrisë së Financave

Elona Mistrovica - përfaqësuese e Ministrisë së Financave

HAPET MBLEDHJA

(Mungesë incizimi)

-...ka të diskutueshme. Është sqaruar vendosja e dispozitave për aktet nënligjore edhe ajo për shfuqizimin e ligjit të mëparshëm që nuk ishte në ligjin e propozuar. Besoj se gjithçka është në rregull. Prokurimi, është bindje e këtij komisionit dhe mbetet për komisionin përgjegjës, për ta kaluar së bashku me ndryshimet e tjera. Kush është dakord? Kundër? Dy. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ja kemi kaluar komisionit përgjegjës që dje.

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 15.07.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për kontrollin e lëndëve narkotike dhe zbatimin e ligjit”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Dashamir Peza, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vasilika Hysi, Anila Agalliu, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungojnë:

Silva Caka, Fatmir Mediu, Tom Doshi.

Të ftuar:

Saimir Tahiri – ministër i Brendshëm

Idajet Faskaj- drejtor i Antinarkotikëve në DPP

Mirela Selita - drejtore e Drejtorisë Juridike në MPB

Argita Alikaj- përgjegjëse në Sektorin e Hartimit të Akteve në Ministrinë e Drejtësisë

Fatmir Xhafaj - Vazhdojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për kontrollin e lëndëve narkotike dhe zbatimin e ligjit”.

Zoti Saimir Tahiri, ministër i Brendshëm është prezent për paraqitjen e projektligjit.

Faleminderit, zoti Ministër!

Në fillim do të dëgjojmë një paraqitje të përmbledhur të ministrit për qëllimin e kësaj marrëveshjeje. Pastaj do të dëgjojmë relatorin për vlerësimin përkatës.

Urdhëroni, zoti Ministër!

Saimir Tahiri - Faleminderit!

Në kuadër të bashkëpunimit të agjencive ligjzbatuese në vend për forcimin e kapaciteteve në luftën kundër krimit të organizuar dhe drejtësisë penale në tërësi, vjen për miratim në këtë komision edhe marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila parashikon ndihmë specifike në kuadër të bashkëpunimit për forcimin dhe qëndrueshmërinë e rezultateve në luftën kundër krimit të organizuar dhe drejtësisë penale.

Marrëveshja parashikon rritjen e kapaciteteve për të hetuar, për të ndjekur penalisht dhe për të gjykuar veprat penale në vend, veçanërisht krimin e organizuar dhe korrupsionin. Ajo parashikon nxitjen e zhvillimit të kapaciteteve profesionale të zyrtarëve në sistemin e ndjekjes, të hetimit të krimit dhe të dhënies së drejtësisë, ashtu siç parashikon edhe ndihmë teknike në lidhje me reformat legjislative apo të kuadrit normativ, përpjekjet për zhvillimin e politikave strategjike në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe drejtësisë penale në tërësi.

Programi i zhvillimit i parashikuar në bazë të marrëveshjes përfshin trajnimin e kapaciteteve, përmirësimin e mundësive teknologjike, asistencën teknike dhe këshillimin apo asistencën e ekspertizës në fushën e rritjes së kapaciteteve të prokurorëve, të hetuesve për të luftuar krimin e organizuar, korrupsionin dhe format e tjera të veprave penale, zhvillimin e sistemit të drejtësisë penale, përmes legjislacionit të përmirësuar dhe rishikimin në tërësi të kuadrit normativ, aty ku është e nevojshme, asistencë për të gjitha hallkat e drejtësisë penale deri te gjyqësori për të gjykuar rastet në kohën e duhur në mënyrë efikase, të paanshme, transparente dhe në përmbushje të plotë të ligjit, si edhe rritjen e aksesit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë, veçanërisht në drejtësinë penale. Gjithashtu, përfshin zhvillimin e komponentëve që kanë të bëjnë me menaxhimin strategjik të zbatimit të ligjit, me zhvillimin operacional të zbatimit të ligjit dhe me zhvillimin e përgjegjësisë policore në raport me qytetarin, në raport me hetimet, me ndjekjen penale, veçanërisht në kuadër të hetimeve kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Ky pak a shumë është qëllimi i kësaj marrëveshje ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila përbën një hap themelor edhe në kuadër të bashkëpunimit intensiv që kemi me agjencitë partnere, veçanërisht me partnerin strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Besoj se miratimi i kësaj marrëveshjeje nga parlamenti do të hapë rrugën që ky bashkëpunim të jetë më efektiv dhe kjo ndihmë e ofruar nga qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për agjencitë ligjzbatuese në vend, për Policinë e Shtetit dhe për të gjithë zinxhirin e drejtësisë penale, do të rrisë rezultatet dhe qëndrueshmërinë e tyre në kuadër të luftës kundër krimit dhe korrupsionit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër për ekspozenë e paraqitur!

Fjalën e ka zoti Majko në cilësinë e relatorit.

Pandeli Majko - Unë nuk do të shtoj ndonjë gjë të veçantë në vazhdim të asaj që tha ministri i Brendshëm. Mendoj se kemi të bëjmë me një marrëveshje shumë të rëndësishme, e cila përcakton disa prej koncepteve më të rëndësishme të luftës së shtetit shqiptar kundër krimit të organizuar, specifikisht për çështjen e kontrollit të lëndëve narkotike dhe zbatimin e ligjit në Shqipëri.

Ashtu siç tha ministri i Brendshëm, çështja e forcimit të ligjit dhe të institucioneve ligjore është një prioritet. Besoj se përkrahja që do të na vijë nga partneri strategjik, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do të jetë shumë e rëndësishme në këtë udhëtim të përbashkët që ne kemi me SHBA-në që nga fillimi i viteve 1990.

Shpresoj, mendoj dhe jam i bindur se kolegët do ta përkrahin këtë marrëveshje të gjithë: si nga maxhoranca ashtu edhe nga opozita.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Majko!

Ka pyetje?

Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi - Unë mendoj se është një marrëveshje e rëndësishme. Pa dyshim që do të marrë edhe miratimin tonë, por kam një pyetje, shtatë milionë dollarë janë vetëm për asistencë teknike apo edhe për pajisje? Në dispozitat e përgjithshme thotë edhe për pajisje. Doja ta kisha të qartë këtë gjë, sepse janë shumë para. I gjithë fondi i misionit EURALIUS për tre vjet është një shifër i tillë, ndërkohë që kjo është e barabartë.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Po, zoti Ministër!

Saimir Tahiri – Faleminderit për pyetjen!

Besoj se gjatë kësaj kohe kemi arritur të intensifikojmë bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë duke filluar me skanimin e situatës dhe me gjetjen e problematikave, boshllëqeve qoftë në kuadrin ligjor, qoftë në zhvillimin infrastrukturor teknologjik të Policisë së Shtetit dhe zinxhirit institucional të drejtësisë penale.

Bazuar mbi këtë vlerësim të situatës dhe mbi hapat konkretë të bashkëpunimit që kemi pasur gjatë kësaj kohe, kemi konkluduar në këtë marrëveshje që është, ashtu siç e thatë edhe ju, një ndihmë substanciale, jo vetëm financiare, por edhe vlera e ekspertizës që merr Policia e Shtetit dhe i gjithë zinxhiri institucional i drejtësisë penale në raport me luftën dhe rezultatet kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Bazuar mbi këtë vlerësim, pa asnjë dyshim buxheti i parashikuar që qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës do të japë për Policinë e Shtetit për institucionet e tjera të përfshira në luftën kundër krimit, është i planifikuar për asistencë të kualifikuar lidhur me ekspertizën dhe hetimin e veprave penale, por edhe me përmirësimin infrastrukturor dhe teknologjik të Policisë së Shtetit dhe të institucioneve të tjera që merren me dhënien e drejtësisë penale dhe luftën kundër krimit dhe korrupsionit.

Ne paralelisht me hartimin e marrëveshjes, kemi ecur përpara me draftimin paraprak të nevojave, që siç e thashë vjen nga analizimi i situatës, gjë që është bërë që në fillim, nga vlerësimi i boshllëqeve që janë evidentuar dora-dorës me bashkëpunimin intensiv që kemi pasur me partnerët dhe sot arrijmë në këtë marrëveshje që fillon të implementohet që nga muaji shtator, në rast se parlamenti do ta miratojë atë. Është një ndihmë mjaft e vyer për ne, sepse forcon substancialisht kapacitetet tona për të pasur një sistem të drejtësisë penale që edhe nëpërmjet kësaj ndihme, qoftë ekspertizë e kualifikuar, qoftë përmirësim infrastrukturor ose teknologjik, do të bëjë të mundur hetime të thelluara, të qëndrueshme dhe rezultate solide në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi - Në të dyja, te dispozitat e përgjithshme dhe të pjesa pronë e personelit jepen të dhëna. Ju i keni identifikuar këto të dhëna për pajisje?

Të nderuar kolegë, shqetësimi im real është ky: është një shumë e madhe që vjen, është jashtëzakonisht mirë, por të mos përdoren vetëm për asistencë teknike. Kemi pasur

vazhdimisht dhe gjatë viteve do të ketë sërish, por të përdoret edhe për pajisje dhe për infrastrukturë.

Fatmir Xhafaj - Zoti Tahiri e sqaroi.

Eduard Halimi – Në fund thuhet se derdhja e fondeve do të bëhet për prokurimin e pronës, të pajisjeve, furnizimeve dhe materialeve. A janë këto pjesë e aneksit, sepse nuk i gjej dot? Këtë po them.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj - Po, zoti Ministër!

Saimir Tahiri - Besoj se e dhashë përgjigjen. Pa asnjë dyshim është një ndihmë shumë e madhe nga qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për agjencitë ligjzbatuese në vend në luftën kundër krimit dhe korrupsionit. Është njëkohësisht një shenjë besimi ndaj asaj që kemi bërë deri më sot dhe inkurajim shumë i madh për të bërë më shumë në kuadër të luftës kundër krimit dhe korrupsionit. Ne kemi këmbëngulur që në fillim, me evidentimin e boshllëqeve dhe mangësive që ka sistemi i drejtësisë penale që ndihma e ofruar të mos jetë vetëm ekspertizë, por të jetë një ndihmë e qëndrueshme që forcon kapacitetet solide të Policisë së Shtetit dhe të zinxhirit institucional të ndjekjes penale, drejtësisë penale dhe institucioneve që kanë kontribut të rëndësishëm në këtë kuadër. Përgjigja është: po, një pjesë e konsiderueshme e fondit, e buxhetit, mbetet këtu nëpërmjet investimeve infrastrukturore dhe teknologjike për ndjekjen penale. Pa asnjë dyshim kjo ka nevojë për ekspertizë, sepse çdo përmirësim teknologjik, infrastrukturor apo çdo përmirësim i kapaciteteve për të hetuar dhe për të përforcuar sistemin e ndjekjes penale, ka nevojë për ekspertizë të shtuar, për forcimin e kapaciteteve njerëzore në Policinë e Shtetit dhe në sistemin e drejtësisë penale që sot na mungon.

Fatmir Xhafaj - Ka pyetje të tjera? Nuk ka. Ka diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, zoti Ministër!

Punë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 15.07.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1.Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2009, për Projektin “Energji Ujore dhe Siguria e Digave në Kaskadën e Drinit”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Dashamir Peza, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vasilika Hysi, Anila Agalliu, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungojnë:

Silva Caka, Fatmir Mediu, Tom Doshi.

Të ftuar:

Ilir Bejtja – zëvendësministër i Energjisë dhe Industrisë

Agim Bregasi – drejtor i Politikave të Zhvillimit Elektroenergjitik i MEI-t

Enea Karakaci – përgjegjës i sektorit juridik i MEI-t

Miranda Lila – këshilltare e ministrit

Anisa Pina - specialiste e medias e MEI-t.

Brikena Jazxhi - përfaqësuese nga Ministria e Financave

Elona Mistrovica – përfaqësuese nga Ministria e Financave

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2009 për projektin “Energjia ujore dhe siguria e digave në kaskadën e Drinit”.

I pranishëm në komision, është zëvendësministri i Energjisë dhe Industrisë zoti Bejtja, si përherë.

Ju lutem, të dëgjojmë një ekspozë për paraqitjen e marrëveshjes.

Po, zoti Bejtja.

Ilir Bejtja – Përshëndetje, zoti kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo marrëveshje është pjesë e marrëveshjeve të mëparshme që kemi me KfW-në lidhur me konsolidimin e sistemit elektroenergjetik shqiptar dhe konsiston në rritjen e sigurisë së digave në kaskadën e Drini. Investimi është kryer që nga vitit 1980 dhe ka pasur vetëm investime lidhur me mirëmbajtjen, ku janë identifikuar edhe probleme që kërkojnë investime për të garantuar funksionimin e mëtejshëm pa rrezik të sistemit të kaskadës së Drinit.

Projekti është i vlerësuar në 20 milionë euro, mjaftueshëm për të garantuar sigurinë e digave, konsiston në riparimin e defekteve që janë vënë re në portat e shkarkimit në Koman dhe në Fierzë, si edhe për të garantuar një ndërhyrje për pastrimin e liqenit të Fierzës për shkak të aluvioneve nga baseni edhe për vendosjen e aparaturave në secilën digë, në të tre digat për të garantuar kontrollin e prurjeve ujore në çdo çast, por edhe për të parashikuar në periudha më të gjata sesa dy javë se cilat do të jenë risqet që mund të shkaktohen nga baseni në sistemin e Drinit.

Projekti është vazhdim i masave të ndërmarra më përpara për riparimin kapital që kemi filluar në hidrocentralin e Komanit, të riparimeve që janë bërë në Vaun e Dejës, po ashtu edhe të të gjithë menaxhimit të koordinuar të kaskadës.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Me këtë rast ju përcjell kërkesën e deputetëve opozitarë që dëshirojnë të kenë ministrin të pranishëm më shumë në Komisionin e Ligjeve. Ai është shumë i ngarkuar me kaskadën e Drinit, por duhet të jetë ndonjëherë edhe me kaskadën e opozitës.

Ilir Bejtja - Unë besoj se ai ma ka transmetuar të gjithë autoritetin, por do t'ia transmetoj këtë kërkesë.

Fatmir Xhafaj - Ka pyetje? Nuk ka. Ka diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, zoti zëvendësministër me autorizimin e plotë të ministrit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 15.07.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

“Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2010 për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Dashamir Peza, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vasilika Hysi, Anila Agalliu, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungojnë:

Silva Caka, Fatmir Mediu, Tom Doshi.

Të ftuar:

Brunilda Paskali – zëvendësministre e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Ardit Çollaku – këshilltar i ministrit

Pranvera Kastrati – përgjegjëse e Sektori pranë MZHETTS-së

Brikena Jazxhi – përfaqësuese e Ministrisë së Financave

Elona Mistrovica - përfaqësuese e Ministrisë së Financave

Fatmir Xhafaj - Vazhdojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2010 për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”.

Zoti Ahmetaj për arsye objektive, pasi është në mbledhjen e qeverisë nuk është i pranishëm, por ne jemi akoma më të kënaqur, sepse kemi këtu zonjën Brunilda Paskali, e cila ka qenë edhe herë tjetër pjesë e këtij komisioni së bashku me këshilltaren e ministrit zonjën Kastrati, e cila gjithashtu ka pasur rastin të jetë në komisionin tonë.

Zonja Paskali, ju lutem të dëgjojmë një ekspozitë të shkurtër të kësaj marrëveshje, meqenëse kolegët janë njohur dhe kanë pasur mundësinë për ta shqyrtuar atë, për efekt rekordesh, por edhe për ndonjë element që ju mendoni se kërkon nënvizim të veçantë.

Brunilda Paskali – Faleminderit, zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Siç u tha nga kryetari jemi sot në këtë komision për të sjellë këtë marrëveshje, miratimin në parim të saj. Kjo marrëveshje ka si qëllim të financojë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale me një vlerë prej 10 milionë eurosh.

Qëllimi i këtij projekti është mbështetja dhe promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, stabilizimi i sistemit financiar shqiptar dhe përmirësimi i kushteve të jetesës së shqiptarëve në zonat rurale, krijimi i vendeve të punës në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, kontributi në reduktimin e pabarazive rajonale, varfërisë rurale, zhvillimi i strukturave të reja të rifinancimit dhe shpërndarjes për dhënien e kredisë në zonat rurale dhe përmirësimi i barazisë gjinore, duke krijuar vende pune dhe të ardhura për gratë në zonat rurale. Kjo mënyrë kreditimi mbështet investimet e qëndrueshme dhe mundësitë e ofrimit të vendeve të reja të punës. Përfitimi më i madh nga ky projekt do të shkojë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në zonat rurale për shkak të kontributit të tyre të konsiderueshëm në punësim. Mundësia e krijimit të vendeve të reja të punës shikohet si një mënyrë e rëndësishme për të shmangur zhvendosjen e popullsisë rurale, si edhe migracionin në qytete.

Qëllimi i këtij programi është edhe disbursimi brenda tre vjetëve pas mbylljes së kontratës së rifinancimit të KfW-së me instrumentet financiare në Shqipëri dhe zgjerimin me të paktën 10% të portofolit të kredive të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në bashkëpunim me klientët ruralë.

Marrëveshja i është prezantuar qeverisë shqiptare që në vitin 2010, por në atë periudhë nuk u bë e mundur të finalizohet. Ndryshimi i vitit 2010 në preambul është i pamundur, pasi fondi është alokuar që në vitin 2010 dhe zëvendësimi me vitin 2015 do të sillte dhe riorganizimin e alokimit të fondit që për KfW-në ishte e pamundur.

Projekti është parashikuar të zbatohet brenda vitit 2015 dhe ky projekt nuk mund të zëvendësohet me projekt e të tjera. Ai do të zbatohet nëpërmjet bankave të nivelit të dytë dhe do të monitorohet nga KfW-ja.

Mënyra e përzgjedhjes së bankës zbatuese do të jetë në përputhje me standardet e tenderëve të hapur ndërkombëtare. Roli i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes do të jetë në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke mundësuar një klimë biznesi të përshtatshme.

Marrëveshja nuk parashikon asnjë efekt financiar apo garanci pasurore nga shteti. Ministria e Zhvillimit të Ekonomisë, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes vlerëson se finalizimi i këtyre marrëveshjeve do të jetë në mbështetje të zhvillimit të biznesit dhe do të lehtësojë vështirësitë e tregut shqiptar për të kredituar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja zëvendësministre për ekspozenë tuaj!

Relatori e ka paraqitur me shkrim materialin, prandaj besoj se nuk ka nevojë për ndonjë koment më shumë. Ka pyetje? Nuk ka. Ka diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kjo mund të quhet edhe dita e konsensusit. Na bashkoi Amerika dhe Gjermania

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA.

